



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.683/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtari Faton Bajrami, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Ndërmarrja Shoqërore “Agrokultura”, me seli në Mitrovicë, përfaqësuar nga Autoriteti i likuidimit Agjencia Kosovare e Privatizimit, me seli në Prishtinë, p.nr., kundër debitorit N.N.Sh.T. Ideali, me seli në Vushtrri, me pronar N.J., e përfaqëson me autorizim Arbër Fazliu, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1898/22, të datës 29.01.2024, me datë 13.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e kreditorit Ndërmarrja Shoqërore “Agrokultura”, me seli në Mitrovicë, përfaqësuar nga Autoriteti i likuidimit Agjencia Kosovare e Privatizimit, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1898/22, të datës 29.01.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1898/22, të datës 29.01.2024, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit N.N.Sh.T. Ideali, me seli në Vushtrri dhe ka shfuqizuar urdhrin përmbarimor P.nr.1576/21, të datës 18.01.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Atip Mustafa me seli në Mitrovicë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, pa i përmendur shkaqet ankimore, me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin e Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1898/22, të datës 29.01.2024, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit, duke e rishikuar aktvendimi KPPP.nr.1898/22, të datës 29.01.2024 i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë dhe të vërtetohet saktë gjendja faktike.

Përgjigje në ankesa nuk ka parashtruar debitori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Ndërmarrja Shoqërore “Agrokultura”, me seli në Mitrovicë, përfaqësuar nga Autoriteti i likuidimit Agjencia Kosovare e Privatizimit, me seli në

Prishtinë, me datën 16.12.2021 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbarimit, kundër debitorit N.N.Sh.T. Ideali, me seli në Vushtri, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës me Nr.17912/2021 të datës 10.11.2021, për shumën e borxhit prej 726.77 €.

Përmbaruesi Privat Atip Mustafa, me seli në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.1576/21, të datës 18.01.2022, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës me Nr.17912/2021 të datës 10.11.2021, me të cilat i ka urdhëruar debitorin, që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës shumë prej 726.77 € si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përmbarimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, përmbushja e detyrimit të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e tyre në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimi, vlerësimi shënimi i përmbarimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e detyrimit të kreditorit, të bëhet përmbarimi në pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimi i sendeve të luajtshme dhe kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajtshme.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1898/22, të datës 29.01.2024, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit N.N.Sh.T. Ideali, me seli në Vushtri dhe ka shfuqizuar urdhrin përmbarimor P.nr.1576/21, të datës 18.01.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Atip Mustafa me seli në Mitrovicë.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret Faturës me Nr.17912/2021 të datës 10.11.2021, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 par. 1 dhe pika 1.3 dhe nenin 37 të LPP-së. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë dokumenti - Faturës, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura nuk ka përcaktuar qartë detyrimin e debitorit, sepse kjo faturë është lëshuar për qiranë mujore për muajin Nëntor 2021 në shumë prej 72.60 euro, ndërsa fatura e paraqitur borxhit total i akumuluar është në emër të qerave të pa paguara është në lartësi prej 726.77 euro, mirëpo nuk është pasqyruar saktë periudha kohore për të cilën është akumuluar ky borxh. Gjithashtu gjykata gjen se e njejta faturë nuk është dorëzuar tek debitorit në mënyrë të rregullt, pasi që i mungon nënshkrimi apo vula e pranimit të debitorit, duke marr parasysht fletë kthesën e Postës së Kosovës, të bashkangjitur në propozim nga ana e kreditorit si dëshmi mbi dorëzimin e faturës, mirëpo këtë dorëzim gjykata nuk mund ta konsideroj si të rregullt, pasi që nuk është specifikuar lloji i dërgesës së adresuar tek debitori, prandaj gjykata vlerëson se fatura nuk tipare të përmbarueshmërisë dhe e njejta nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm. Prandaj, Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi të atakuar.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbaremore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se fatura e lëshuar nga ana e kreditorit nuk ka titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përmbareueshmërisë sepse nuk është përcaktuar saktë shumë e kërkuar në bazë të urdhëri përmbaremore dhe e akumulimit të borxhit. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 29 para. 1 të LPP-së, përcakton *“Përmbaremi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa par.3 i LPP, i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbaremi po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbareueshmërisë së detyrimit monetar”*. Ndërkaq neni 37 të LPP-së *“Kur propozimi për përmbaremi paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, pra këtë rast nuk kemi të saktësuar kredia që duhet të realizohet apo shumë e saktë, prandaj nuk mund të cilësohet si dokument i përshtatshëm për përmbaremi. Me nenin 22 të par.1 nën par.1.9 të LPP-së, i cili parasheh mundësinë që si dokument përmbareues të shërbejë edhe dokumenti të cilit me ligj të veçantë i është njohur atributi i tillë, pra këtu kemi të bëjmë me mungesën e vendimit mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore, të cilit dokument me ligj të veçantë i është njohur cilësia e dokumentit përmbareues për arkëtimin e detyrimeve tatimore.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhomat e shkallës së parë kanë konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbaremore, respektivisht është lejuar përmbaremi nuk i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t’i ketë dokumenti i përmbaremore. Në rastin konkret qartë rezulton se fatura nuk e përmbanë qartë detyrimin e debitorit, i cili është ndër kushtet esenciale mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbareueshmërisë së titullit ekzekutiv, prandaj nuk mund të cilësohet si dokument i përshtatshëm për përmbaremi. Gjithashtu fatura nuk është dorëzuar tek debitorit në mënyrë të rregullt, pasi që i mungon nënshkrimi apo vula e pranimit të debitorit. Së këndejmi, Gjykata thekson se nuk ka rregullësi dhe përshtatshmëri të dokumentit përmbaremore, në bazë të faturës së lartëcekur.

Së këndejmi, edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbaremore organi përmbareues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbaremit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përmbareues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbareues dhe/apo atij të besueshëm, me ç’rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv. Kur nga dokumenti i besueshëm nuk shihet se a është bërë e kërkueshme kredia, atëherë përmbaremi caktohet vetëm në qoftë se kreditori paraqet deklaratë me shkrim se kredia e tij është bërë e kërkueshme duke u treguar edhe dita për një gjë të tillë

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të

cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbare.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.683/24 dt. 13.05.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami.